



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOCATES BAR ASSOCIATION
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA

Republika e Kosovës / Republika Kosovo		
ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA VENDIMI I KËMBIMIT I FORMËS SË PRERË CDLUKA JE PRAVNOSSHATËRA		
Data	25.08.	2023
Dana	Punëtori i autorizuar Ovčević radnik	

V.KA.nr.1258-3/22

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Av. Ruzhdi Berisha – kryetar i kolegjit, Av. Luljeta Jashari - Hertica dhe Av. Agron Rexhaj – anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Laura Pireva, praktikante në OAK-së, duke vendosur sipas kundërshtimit Nr.1258-1/2023 të datës 07.09.2023 të parashtruar nga Av. _____, nga Prishtina, kundër vendimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor të OAK-së, në Prishtinë, nr. 1258-3 dt. 25 gusht 2023, në seancën jo publike të mbajtur me datën 26 tetor 2023 mori këtë

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar kundërshtimi Nr.1258-1/2023 dt. 07.09.2023, i parashtruar nga Av. _____, nga Prishtina dhe **VËRTETOHET** vendimi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës nr. 1258-3/2023 dt. 25 gusht 2023.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës nr. 1258-3/2023 dt. 25 gusht 2023, bazuar në nenin 11 par. 1 nënpar. 1.1 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikant, në pjesën e dispozitivit në I, hudhet fletëparaqitja disiplinore nr. 1258/2022 e datës 01.11.2022 e ushtruar nga av. _____, kundër av. _____.

Në pjesën e dispozitivit në II konstatohet se nuk është vërtetuar që i paraqituri av. _____ të ketë bë shkelje disiplinore në raport me ushtruesin e fletëparaqitjes disiplinore, av. _____.

Kundër vendimit në fjalë, në afat, ka paraqitur kundërshtim ushtruesi i fletëparaqitjes, av. _____, duke e kundërshtuar atë në tërësi për shkak të shkeljes së normativës së Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), nga se konsideron se me atë është bë shkelje e normativës së OAK-së, pa u përcaktuar konkretisht ku qëndron ajo dhe pa ndënjë propozim konkret për mënyrën e vendosjes në bazë të kundërshtimit të paraqitur.

I paraqituri, av. _____, ka paraqitur përgjigje në kundërshtim, duke theksuar se vendimi i kundërshtuar është i drejtë dhe i ligjshëm me propozim që kundërshtimi i paraqitur të refuzohet si i pabazuar.

Komisioni i Ankesave i OAK-së, si organ i shkallës së dytë, pas kontrollimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kundërshtim, në mbështetje të nenit 110 par.1 të Statutit të OAK-së, si dhe nenit 45 par.1 pika 1.2, 48 dhe 51 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, ka gjetur se:

Kundërshtimi i av. _____, nga Prishtina, është i pabazuar.

Siç shihet nga shkresat e lëndës, av. _____, nga Prishtina, më 01.11.2022, në Zyrën e Prokurorit Disiplinor të OAK-së ka paraqitur fletëparaqitje disiplinore kundër av. _____, nga Prishtina, duke theksuar se i njëjti, duke vepruar në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Disiplinor të OAK-së, nxjerr aktvendimin V.KD. nr. 18-3/22 dt. 11.10.2022 duke konsideruar se me nxjerrjen e tij ka veprua në kundërshtim me nenet 8 par. 1, 32, 34 dhe 35 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Meqë fletëparaqitja disiplinore në fjalë, me vendimin e sipërshtuar të ZPD-së të OAK-së hudhet me konstatim se nuk është vërtetuar se i paraqituri av. _____, nga Prishtina, ka kryer shkelje disiplinore nga fletëparaqitja disiplinore, të parashikuar me normativën e OAK-së, av. _____ ka paraqitur kundërshtim kundër këtij vendimi, duke konsideruar se ai është nxjerr më shkelje të normativës së OAK-së, pa theksuar konkretisht cilat janë ato shkelje dhe ajo normativë.

Në kundërshtimin e paraqitur, në pjesën më të madhe të tij, jepen vlerësime për personalitetin e personit i cili ushtron funksionin e prokurorit të OAK-së dhe i cili ka vendosur lidhur me fletëparaqitjen disiplinore në fjalë të paraqitur nga av. _____ ndaj av. _____

, për shkak se ky i fundit në cilësinë e kryetarit të Komisionit Disiplinor të OAK-së, e ka refuzuar kërkesën e ushtruesit të kundërshtimit për përjashtimin e prokurorit disiplinor dhe antarëve të kolegjit disiplinor në një procedurë tjetër disiplinore të zhvilluar. Në pjesën tjetër të kundërshtimit bëhet fjalë lidhur me objektivitetin dhe personalitetin edhe të të paraqiturit av. _____, përkitazi me veprimet e tij jashtë çështjes e cila është objekt shqyrtimi, nga edhe këto të paraqitura nuk kanë qenë me ndikim me rastin e vendosjes.

Komisioni për ankesa, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konstaton se vendimi i kundërshtuar i Zyrës së Prokurorit Disiplinor i OAK-së është i drejtë dhe i ligjshëm. I paraqituri av. _____, duke vendosur si në aktvendimin V.KD. nr. 18-3/22 dt. 11.10.2022, ka vepruar sipas kërkesës së paraqitur nga av. _____ e në bazë të autorizimeve që ka pasur në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Disiplinor. Duke vepruar në bazë të autorizimeve që ka Kryetari i Komisionit Disiplinor, për mënyrën e vendosjes në këtë cilësi në kuadër të autorizimeve që ka, nuk mund të ketë përgjegjësi disiplinore. Me nxjerrjen e një vendimi në bazë të kërkesës për përjashtimin e Prokurorit të OAK-së dhe antarëve të kolegjit disiplinor, pavarësisht nga mënyra e vendosjes, nuk mund të konsiderohet se është vepruar në kundërshtim me nenet 8.1, 32, 34 dhe 35 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, siç theksohet në fletëparaqitjen disiplinore e as se është bërë shkelje disiplinore. Nga kjo arsye edhe, bazuar në nenin 11 par. 1 nënpar. 1.1 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokat dhe Praktikant, me aktvendimin e kundërshtuar me të

drejtë është hedhur fletëparaqitja disiplinore e paraqitur nga se në veprimet e parashtruara në fletëparaqitje nuk mund të ketë elemente të shkeljes disiplinore nga Kodi i Etikës Profesionale të Avokatit.

Nga arsyet e cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
PRISHTINË V.K.A.nr. 1258-4/22 dt. 26.10.2023

Kryetari i kolegjit,
Av. Ruzhdi Berisha

